

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të datës 07.07.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe nenit 63 paragrafi (1) dhe (2), nenit 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të RMV, duke vendosur për iniciativën e parashtruar nga avokati Tonevski Dragan nga S. nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Iniciativa e parashtruar nga Avokati Dragan Tonevski nga S., evidentuar nën Su-03 nr.295/22 të datës 09.05.2022, me kërkesë që të miratohet qëndrim parimor ose mendim juridik parimor me zbatimin e Ligjit për agjencitë për punësimë të përkohshme, konkretisht neni 3-a paragrafi (7) dhe neni 3-b paragrafi 1, HIDHET POSHTË SI JO E PLOTË.

### A r s y e t i m

Sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06....96/19), Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të RMV, më 07.07.2022 diskutoi mbi iniciativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor Su-03 nr.295/22 të datës 09.05.2022, të parashtruar nga avokati Dragan Tonevski nga S. Në iniciativë theksohet se, drejtohet me kërkesë që të miratohet qëndrim parimor ose mendim juridik parimor me kuptim të sigurimit të barazisë me zbatimin e Ligjit për agjencitë për punësimë të përkohshme, konkretisht neni 3-a, paragrafi (7) dhe neni 3-b paragrafi (1), pa e formuluar paraprakisht çështjen juridike, për të cilën duhet të prononcohet Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të RMV.

Në iniciativë e thekson fakti grafinë e lëndëve RO nr.74/19 dhe TS nr.16/20 të GJTH Strumicë, që pastaj në esencë e sqaron nenin 3-a paragrafi (7) dhe nenin 3-b paragrafi (1) të Ligjit për agjencitë për punësimë të përkohshme.

Më tutje, në iniciativë theksohet vendimi nga Gjykata Themelore Manastir RO nr.361/18, ku sipas parashtruesit të iniciativës janë zbatuar me të drejtë nenet e theksuara më parë. Në iniciativën theksohet edhe se Gjykata e Apelit në Shkopje ka zbatim të pabarabartë të neneve të theksuara më parë duke vendosur në shkallën e dytë për lëndët TS nr.3/21.

Duke marrë parasysh faktin që parashtruesi i iniciativës nuk ka vendosur çështje juridike, për të cilën Seanca e përgjithshme duhet të diskutojë, ndërsa formulimi i theksuar në iniciativën vetëm për zbatimin e nenit 3-a paragrafi (7) dhe nenit 3-b paragrafi (1) të Ligjit për agjencitë për punësimë të përkohshme, nuk mund të konsiderohet si çështje juridike për të cilën do të vepronë Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të RMV. Kjo mangësi e bën iniciativën jo të tërësishme.

Është e paqartë se në cilën pjesë dhe për cilën çështje juridike ka pabarazi në zbatimin e dispozitave të theksuara nga ligji i theksuar, vallë në realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës të punëtorëve të transferuar te punëdhënësi shfrytëzues ose lidhur me çështjen e kërkesës së regresit. Është e paqartë në cilin drejtim dëshiron parashtruesi i iniciativës që të diskutojë Gjykata Supreme.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Seanca e përgjithshme